



Në bazë të nenit 17, paragrafi (7) të Ligjit për Punësuarit në Sektorin Publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 143/19 dhe 14/20), u.d. drejtori i Entit Shtetëror të Pronësisë Industriale miraton

Бр./Nr. 01-1068/1-2024

Дата/Date 08/08/2024



Државен завод за
индустриска сопственост
ул. Даме Груев бр.14,
1000 Скопје,
Република Северна
Македонија
Тел. (02) 3103-601
Факс. (02) 3137-149
Сайт: www.ippo.gov.mk

**Enti Shtetëror për Pronësi
Industriale**

rr. Dame Gruev nr. 14
1000 Shkup,
Republika e Maqedonisë
së Veriut
Tel. (02) 3103-601
Faks. (02) 3137-149
Web faqja:
www.ippo.gov.mk

RREGULLORE

**për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin
e vendeve të punës në
Entin Shtetëror të Pronësisë Industriale**

Neni 1

Me këtë Rregullore bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Entin Shtetëror të Pronësisë Industriale

nr. 01-1863/1 nga data 30.10.2015 dhe Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Ent nr. 01-309/1 nga data 21.02.2018, nr. 01-1196/1 nga data 12.08.2019, nr. 01-846/1 nga data 13.07.2020, nr. 01-1437/1 nga data 14.12.2020, nr. 01-450/1 nga data 14.04.2021, nr. 01-169/1 nga data 03.02.2022 dhe nr. 01-1171/1 nga data 22.08.2022.

Neni 2

Në pjesën III. PËRSHKRIMI I VENDEVE TË PUNËS NË ENTIN SHTETËROR TË PRONËSISË INDUSTRIALE, në "Sektorin për Markat Tregtare, Dizajnin Industrial dhe Treguesit Gjeografikë dhe Bashkëpunimin Dypalësh me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelktuale (OBPI) dhe Zyrën e Bashkimit Evropian për Pronësi Intelktuale (EUIPO)," në "Njësinë për Dizajnin Industrial dhe Treguesit Gjeografikë dhe Bashkëpunimin Dypalësh me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelktuale (OBPI) dhe Zyrën e Bashkimit Evropian për Pronësi Intelktuale (EUIPO)" për vendin e punës me numër "36" dhe kodin ADM 0101 V04 000, me titullin e vendit të punës: "Bashkëpunëtor i Ri për përgatitjen e raporteve, konfirmimeve dhe ekstrakteve për Dizajnin Industrial", në pjesën "Lloji i arsimit" fjalët "Shkenca juridike ose Arsim" zëvendësohen me fjalët "Shkenca shoqërore - të drejta ose shkenca politike".

Neni 3

Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit, dhe do të zbatohet pas marrjes së miratimit nga Ministria e Administratës Publike.

u.d. DREJTORI,
Eljesa Nezir

